



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 16 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, gjegjësisht nenin 39 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe neneve 3.1 dhe 3.3 të Rregullës Zgjedhore 12/2013 Kufizimi i shpenzimeve të fushatës dhe deklarimi financiar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 24.10.2020, merr këtë:

VENDIM

Për kufizimin e shpenzimeve të fushatës për subjektet politike për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në komunën Podujevës

- I. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton kufirin e sipërm të shpenzimeve të fushatës për subjektet politike për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në komunën e Podujevës që do të mbahen më 29 nëntor 2020 në shumën prej 43,931.50 euro.
- II. Neni 3.1 Rregullës Zgjedhore nr. 12/2013 shpreh që kufizimi i shpenzimeve të fushatës dhe deklarimi financiar, parasheh që kufizimi i shpenzimeve të fushatës do të jetë 0.5 euro për votues të regjistruar në komunën përkatëse. Numri i votuesve në komunën e Podujevës, sipas listës preliminare të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës është 87,863 votues të regjistruar.
- III. Shpenzimet maksimale për fushatë nga pika 1 e këtij vendimi zbatohen për çdo mall dhe shërbim të shpenzuar për qëllimet e fushatës që është zbatuar nga data 3 mars 2020 deri 13 mars 2020 dhe për periudhën shtesë të fushatës nga data 23 nëntor 2020 deri më 27 nëntor 2020, pa marrë parasysh kohën e blerjes së shërbimeve.
- IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve numër 142/2020 i datës 11 shkurt 2020.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

